


LegalNews

June - October 2025
Qershor - Tetor 2025



Deloitte.

Regjistri Elektronik i Nëpunësve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale

Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 347, datë 19.6.2025 "Për Krijimin e Bazës së të Dhënave Shtetërore "Regjistri Elektronik i Nëpunësve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale" ("**Vendimi**"), në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore" ("**Ligji për bazat e të dhënave shtetërore**").

Vendimi i publikuar në Fletoren Zyrtare me nr. 108, datë 23.06.2025 krijon Regjistrin Elektronik të Nëpunësve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale ("**Regjistri**")

Regjistri krijohet pranë institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ("**Komisioneri**") dhe përmbajtja e tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionerit.

Komisioneri është përgjegjës për krijimin, mbajtjen, administrimin, ndërveprimin me bazat e tjera dhe bërjen të disponueshëm të informacionit, në përmbajtje të Regjistrit.

Të dhënat e nëpunësve mbahen sipas përcaktimeve nga kontrolluesit dhe përpunuesit.

Të dhënat në Regjistër ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore, si më poshtë:

I. Të dhëna parësore

Të dhënat parësore janë:

- Të dhënat mbi nëpunësit;
- Adresa e postës elektronike;
- Adresa e ushtrimit të veprimtarisë;
- Numri i kontaktit;
- Të dhënat mbi kontrolluesit/

Electronic Register of Personal Data Protection Officers

The Council of Ministers has adopted Decision no. 347, dated 19.6.2025, "On the Establishment of the State Database 'Electronic Register of Personal Data Protection Officers'" ("**Decision**"), pursuant to and for the implementation of Law no. 10325, dated 23.9.2010, "On State Databases" ("**Law on State Databases**").

The Decision, published in the Official Gazette no. 108, dated 23.6.2025, establishes the Electronic Register of Personal Data Protection Officers ("**Register**").

The Register is established at the institution of the Commissioner for the Right to Information and Protection of Personal Data ("**the Commissioner**") and its content is published on the official website of the Commissioner.

The Commissioner is responsible for the creation, maintenance, administration, interaction with other databases, and making available the information contained in the Register.

The officers' data are maintained according to the determinations of the controllers and processors.

The data in the Register are divided into primary and secondary data, as follows:

I. Primary data

Primary data are:

- Data on the officers;
- E-mail address;
- Address of the activity;
- Contact number;
- Data on the controllers/processors

- përpunuesit, ku është caktuar nëpunësi;
- f. Trajnimet dhe certifikatat e nëpunësit, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

II. Të dhënat dytësore

Të dhënat dytësore janë ato të dhëna që merren nga ndërveprimi me bazat e të dhënave shtetërore, si më poshtë vijon:

- a. Nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile;
- b. Nga Regjistri Tregtar i QKB-së;
- c. Nga Regjistri Elektronik Kombëtar i Organizatave Jofitimprurëse

Niveli i aksesit në sistemin dhe në bazën e të dhënave të Regjistrit

- **Qytetarët** (subjektet e të dhënave) kanë nivel aksesit si lexues dhe konsultues, të informacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet faqes së internetit të Komisionerit;
- **Nëpunësit dhe kontrolluesit e përpunuesit publikë dhe privatë** kanë nivel aksesit si lexues dhe konsultues, të informacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet faqes së internetit të Komisionerit;
- **Komisioneri** ka akses si administrator dhe përdorues i Regjistrit.

Vendimi ka hyrë në fuqi me publikimin e tij në Fletoren Zyrtare.

- where the officer is appointed;
- f. The officer's training and certificates in the field of personal data protection.

II. Secondary data

Secondary data are obtained from the interaction with state databases, as follows:

- a. From the National Civil Status Register;
- b. From the National Business Center (NBC) Commercial Register;
- c. From the National Electronic Register of Non-Profit Organizations.

Level of access to the system and to the Register's database

- **Citizens** (data subjects) have access as readers and consultants of the information made available through the Commissioner's website;
- **Officers and controllers/processors, public and private,** have access as readers and consultants of the information made available through the Commissioner's website;
- **The Commissioner** has access as administrator and user of the Register.

The Decision entered into force upon its publication in the Official Gazette.

Përpunimi i të Dhënave Personale nga Autoritetet Kompetente

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar Udhëzimin nr. 5, datë 16.7.2025 "Për Përpunimin e të Dhënave Personale nga Autoritetet Kompetente" ("**Autorizimi**"), në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 124/2024, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" ("**Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**").

Udhëzimi i publikuar në Fletoren Zyrtare me nr. 130, datë 22.07.2025 përcakton rregullat për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale nga ana e Autoriteteve Kompetente për sigurinë publike ose kombëtare dhe për parandalimin e ndjekjen e veprave penale, të cilët gjatë veprimtarisë përpunojnë të dhëna personale.

Autoritetet Kompetente

Autoritetet Kompetent është gjykata, prokuroria dhe çdo organ publik, që ka në kompetencë parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen e veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, përfshirë mbrojtjen dhe parandalimin e kërcënimeve ndaj sigurisë publike, mbrojtjes ose sigurisë kombëtare ose çdo institucion tjetër, të cilit i është dhënë me ligj e drejta për të ushtruar funksione, detyra ose kompetenca publike, në bazë të legjislacionit në fuqi për një ose disa prej këtyre qëllimeve.

Autoritetet Kompetente duhet të garantojnë zbatimin e parimeve të ligjshmërisë, përpunimit në përputhje me qëllimin, minimizimit të të dhënave, saktësisë, kufizimit të ruajtjes në kohë, integritetit, konfidencialitetit dhe përgjegjshmërisë.

Processing of Personal Data by Competent Authorities

The Commissioner for the Right to Information and Protection of Personal Data has adopted Instruction no. 5, dated 16.7.2025 "On the Processing of Personal Data by Competent Authorities" ("**Instruction**"), pursuant to and for the implementation of Law no. 124/2024, "On the Protection of Personal Data" ("**Law on the Protection of Personal Data**").

The Instruction, published in the Official Gazette no. 130, dated 22.07.2025, sets out the rules for the lawful processing of personal data by Competent Authorities for public or national security and for the prevention and prosecution of criminal offences, which, in the course of their activity, process personal data.

Competent Authorities

A Competent Authority is the court, the prosecution office, and any other public body, which has competence for the prevention, investigation, detection or prosecution of criminal offences, or the execution of criminal penalties, including the protection and prevention of threats to public security, defense or national security, or any other institution to which the law has granted the right to exercise public functions, duties or competences, on the basis of the legislation in force for one or more of these purposes.

Competent Authorities must ensure the implementation of the principles of lawfulness, purpose limitation, data minimization, accuracy, storage limitation, integrity, confidentiality and accountability.

Autoritetet Kompetente caktojnë një Nëpunës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kategoritë e të Dhënave Personale

Të dhënat personale që përpunohen nga autoritetet kompetente, kategorizohen si më poshtë vijon:

- a. të dhëna të përgjithshme identifikuese;
- b. të dhëna sensitive, përfshirë përkatësinë etnike ose racore, mendimet politike, besimin fetar, anëtarësinë në sindikata, të dhëna biometrike dhe gjenetike, të dhëna për shëndetin, jetën ose orientimin seksual;
- c. të dhëna që lidhen me dënime penale, veprat penale dhe masat e sigurimit në lidhje me to etj.

Në rastet e përpunimit të të dhënave personale të bazuara në vlerësime personale duhet të mbahet një regjistër i veçantë, duke specifikuar edhe arsyet apo rrethanat për këtë vlerësim.

Ndërveprimi i Sistemeve

Autoritetet kompetente komunikojnë nëpërmjet ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore apo sistemeve, të dokumentuar në zbatim të qëllimit të veprimtarisë së tyre.

Të gjitha autoritetet kompetente që bashkëpunojnë duhet të garantojnë që përpunimi i të dhënave dhe përhapja e tyre, në zbatim të ligjit, të kryhet në mënyrë konfidenciale dhe të realizohet vetëm nga punonjës të autorizuar.

Përpunimi i të dhënave kryhet vetëm në masën e domosdoshme për përmbushjen e qëllimit pa e tejkaluar atë.

Competent Authorities appoint a Data Protection Officer.

Categories of Personal Data

The personal data processed by Competent Authorities are categorized as follows:

- a. general identifying data;
- b. sensitive data, including ethnic or racial origin, political opinions, religious beliefs, trade union membership, biometric and genetic data, health data, sexual life or sexual orientation;
- c. data relating to criminal convictions, criminal offences and security measures related thereto, etc.

In cases of processing personal data based on personal assessments, a separate register must be kept, also specifying the reasons or circumstances for such assessment.

Interoperability of Systems

Competent Authorities communicate through the interoperability of state databases or systems, documented in implementation of the purpose of their activity.

All cooperating Competent Authorities must ensure that the processing and dissemination of data, in accordance with the law, is carried out confidentially and only by authorized employees.

The processing of data shall be carried out only to the extent necessary for the fulfilment of the purpose, without exceeding it.

Të dhënat sensitive përpunohen vetëm kur ky përpunim është absolutisht i nevojshëm, kur zbatohen masa të përshtatshme mbrojtëse për të drejtat dhe liritë themelore të subjekteve të subjekteve të të dhënave, si dhe nëse:

- a. autorizohet në mënyrë specifike me ligj;
- b. të dhënat, janë bërë haptazi publike nga subjekti i të dhënave dhe i shërbejnë një qëllimi për të cilin kontrolluesi është kompetent sipas ligjit.

Të Drejtat e Subjekteve të të Dhënave Personale

Autoriteti kompetent, ka detyrimin t'i sigurojë subjektit të të dhënave ushtrimin e të drejtës për informim, të drejtës për akses dhe të drejtës për korrigjim ose fshirje të të dhënave personale dhe për kufizimin e përpunimit, duke i ofruar informacionin në një formë koncize, transparente, të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme.

Masat e Sigurisë

Autoritetet kompetente duhet të ndërmarrin masa teknike dhe organizative, për të garantuar mbrojtjen e të dhënave personale dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave, të përcaktuara si më poshtë:

- Kryerja e vlerësimit të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave;
- Mbrojtja e të dhënave në projektim dhe në mënyrë të paracaktuar;
- Marrja e masave teknike dhe organizative që në kohën e planifikimit të një sistemi përpunimi;
- Dokumentimi i veprimtarive të përpunimit;

Sensitive data shall be processed only when such processing is absolutely necessary, when appropriate safeguards are applied for the fundamental rights and freedoms of data subjects, and if:

- a. specifically authorized by law;
- b. the data have been made publicly available by the data subject and serve a purpose for which the controller is competent under the law.

Rights of Data Subjects

The Competent Authority has the obligation to ensure that the data subject can exercise the right to information, the right of access, and the right to rectification or erasure of personal data and to restriction of processing, by providing the information in a concise, transparent, intelligible and easily accessible form.

Security Measures

Competent Authorities shall undertake technical and organizational measures to ensure the protection of personal data and the respect of the rights and freedoms of data subjects, as specified below:

- Data protection impact assessments;
- Data protection by design and by default;
- Taking technical and organizational measures at the planning stage of a processing system;
- Document processing activities;
- Ensure the level of data security;
- Notify the Commissioner and the data subject;

- Garantimi i nivelit të sigurisë së të dhënave;
- Njoftimi i Komisionerit dhe subjektit të të dhënave;
- Detyrimi për konfidencialitet të të dhënave të përpunuara;
- Përpunimi i të dhënave sensitive.

Mekanizmat Konfidencialë të Raportimit

Autoritetet kompetente krijojnë dhe përdorin mekanizma të sigurt dhe konfidencialë, që garantojnë raportimin e shkeljeve të ligjit, si më poshtë:

- a. e-mail i dedikuar me qasje të kufizuar;
- b. platformë online për përdorim të brendshëm, sipas aksesit të autorizuar;
- c. kuti/pajisje fizike të dedikuara të raportimit, të vendosura në ambientet e institucionit;
- d. raportim verbal me mbajtje protokolli në zyrë të caktuar;
- e. do formë tjetër raportimi që përmbush kërkesat e ligjit.

Ruajtja dhe fshirja e të dhënave

Autoritetet Kompetente duhet të parashikojnë në kuadrin e tyre rregullator afate të përshtatshme kohore për fshirjen e të dhënave personale, afate të rishikimit periodik të ruajtjes së tyre, si dhe të ndërmarrin masa konkrete për respektimin e këtyre afateve, duke pasur në konsideratë se:

- Të dhënat personale ruhen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për përmbushjen e qëllimit/ve dhe fshihen ose anonimizohen kur nuk janë më të nevojshme.
- Të dhënat personale mund të ruhen për periudha më të gjata për qëllime arkivimi në interes

- Maintain confidentiality in data processing;
- Processing of sensitive data.

Confidential Reporting Mechanisms

Competent Authorities establish and use secure and confidential mechanisms to ensure the reporting of legal violations, as follows:

- a. dedicated e-mail with restricted access;
- b. internal online platform, according to authorized access;
- c. dedicated physical reporting boxes/devices, placed in the premises of the institution;
- d. verbal reporting with protocol recording in a designated office;
- e. any other form of reporting that fulfils the requirements of the law.

Storage and Deletion of Data

Competent Authorities must foresee in their regulatory framework appropriate time limits for the deletion of personal data, deadlines for the periodic review of their retention, as well as undertake concrete measures for the observance of such deadlines, taking into consideration that:

- Personal data shall be retained only for as long as is necessary for the fulfilment of the purpose(s) and shall be erased or anonymized when no longer necessary.
- Personal data may be retained for longer periods for archiving in the public interest, scientific

publik, kërkimore shkencore, historike ose statistike, me kusht zbatimin e masave të duhura teknike dhe organizative si pseudonimizimi ose anonimizimi, në përputhje me "parimin e kufizimit të ruajtjes në kohë".

- Të dhënat duhet të jenë të sakta dhe duhet të respektohen periudhat e ruajtjes në të gjitha veprimtaritë e përpunimit.
- Të dhënat personale duhet të përditësohen kur nuk janë të sakta dhe të fshihen kur nuk janë më të nevojshme, ndërsa korrigjimi ose fshirja duhet t'u komunikohet të gjithë marrësve përkatës të të dhënave.

Kriteret për rishikimin e nevojës për vazhdimin e ruajtjes së të dhënave

Në përcaktimin e nevojës për vazhdimin e ruajtjes së të dhënave personale, duhet të merren parasysh kriteret e mëposhtme:

- a. Mosha e subjektit të të dhënave;
- b. Dënimet e shlyera;
- c. Vendimet gjyqësore.

Udhëzimi ka hyrë në fuqi me publikimin e tij në Fletoren Zyrtare.

or historical research or statistical purposes, subject to the implementation of appropriate technical and organizational measures such as pseudonymization or anonymization, in accordance with the "storage limitation principle."

- Data must be accurate and retention periods must be respected in all processing activities.
- Personal data must be updated when they are no longer accurate and erased when no longer necessary, while rectification or erasure must be communicated to all relevant recipients of the data.

Criteria for Reviewing the Necessity of Data Retention

In determining the necessity for continuing the retention of personal data, the following criteria must be considered:

- a. the age of the data subject;
- b. served sentences;
- c. judicial decisions.

The Instruction entered into force upon its publication in the Official Gazette.

Metodologjia e Përlllogaritjes së Masës së Sanksioneve Administrative

Në Fletoren Zyrtare nr. 131 datë 23.07.2025 është publikuar Udhëzimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Nr. 6, datë 16.7.2025 "Për Miratimin e Metodologjisë për Përlllogaritjen e Masës së Sanksioneve Administrative" (në vijim referuar si "**Metodologjia**").

Metodologjia përbën një instrument detyrues për Drejtorinë e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale pranë Zyrës së Komisionerit, për vlerësimin e drejtë, transparent dhe korrekt të masës së sanksionit administrativ ndaj një kontrolluesi/përpunuesi të caktuar, shkelës të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, siç përcaktohet në ligjin nr. 124, datë 19.12.2024, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (në vijim "**Ligji për mbrojtjen e të dhënave**" / "**Ligji**").

Metodologjia përbëhet nga 5 (pesë) hapa, si më poshtë vijon:

- 1. Hapi 1:** identifikohet veprimtaria përkatëse e përpunimit të të dhënave dhe vlerësohet shkelja e dispozitave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave.
- 2. Hapi 2:** përcaktohet modeli i përlllogaritjes së mëtejshme të sanksionit, bazuar në një vlerësim të:
 - a. Klasifikimit të shkeljes;
 - b. Seriozitetit të shkeljes;
 - c. Xhiros së ndërmarrjes.
- 3. Hapi 3:** vlerësohen rrethanat rënduese dhe/ose lehtësuese që lidhen me sjelljen e mëparshme

Methodology for Calculating the Amount of Administrative Sanctions

In Official Gazette No. 131 dated 23.07.2025, was published the Instruction No. 6, dated 16.7.2025, "On the Approval of the Methodology for Calculating the Amount of Administrative Sanctions" of the Commissioner on the Right to Information and Personal Data Protection, (hereinafter referred to as the "**Methodology**").

The Methodology constitutes a binding instrument for the General Directorate of Personal Data Protection at the Commissioner's Office, for the fair, transparent, and correct assessment of the administrative sanction amount against a specific controller/processor, violator of the personal data protection legislation, as defined in Law No. 124, dated 19.12.2024, "On the Protection of Personal Data" (hereinafter the "**Personal Data Protection Law**" / "**the Law**").

Methodology consists of five (5) steps, as follows:

- 1. First step:** Identification of the relevant data processing activity and assessment of the violation of the provisions of the personal data protection law.
- 2. Second step:** Determination of the model for further calculation of the sanction, based on an assessment of:
 - a. Classification of the violation;
 - b. Severity of the violation;
 - c. Turnover of the enterprise.
- 3. Third step:** Assessment of aggravating and/or mitigation of circumstances related to the

ose aktuale të kontrolluesit/
përpunuesit;

4. Hapi 4: identifikohet tavani ligjor i masës së sanksionit lidhur me proceset/veprimtaritë e ndryshme të përpunimit.

5. Hapi 5: analizohet nëse shuma përfundimtare e sanksionit të përlogaritur plotëson kërkesat e efektivitetit, proporcionalitetit dhe karakterit parandalues të saj.

HAPI 1: IDENTIFIKIMI I PROCESEVE/VEPRIMTARISË SË PËRPUNIMIT

Shkeljet konkurruese

Përpara se të përlogaritet masa e një sanksioni, merret parasysh se mbi çfarë sjelljeje dhe shkeljeje bazohet masa e sanksionit.

Një rast i veçantë mund të përfshijë rrethana që mund të konsiderohen:

- i. si një sjellje e sanksionueshme; ose si
- ii. disa sjellje të veçanta të sanksionueshme.

Një sjellje e vetme të mund të shkaktojë një numër shkeljesh të ndryshme, të cilat mund të përjashtojnë njëra-tjetrën ose mund të bashkë qëndrojnë/renditen te njëratjetra.

Në varësi të rregullave të konkurrueshmërisë, këto shkelje mund të shpien në përlogaritje të ndryshme sanksionesh.

previous or current behavior of the controller/processor.

4. Fourth step: Identification of the legal ceiling of the sanction amount concerning the different processing activities.

5. Fifth step: Analyzing whether the final calculated sanction amount meets the requirements of effectiveness, proportionality, and deterrent character.

FIRST STEP: IDENTIFICATION OF PROCESSING ACTIVITIES

Competing Violations

Before calculating the amount of a sanction, it is considered on which conduct and violation the sanction is based.

A specific case may include circumstances that may be considered:

- i. as sanctionable behavior; or
- ii. several specific sanctionable behaviors.

A single behavior may also give rise to multiple violations, which may exclude each other or coexist.

Depending on the rules of concurrency, these violations may lead to different sanction calculations.

HAPI 2: PIKËNISJA E PËRLLOGARITJES SË MASËS SË SANKSIONIT ADMINISTRATIV

Përlllogaritja e masës së sanksionit duhet të fillojë nga një pikënisje e caktuar.

Zyra e Komisionerit konsideron 3 (tri) elemente thelbësore në përcaktimin e pikënisjes për përlllogaritjen e sanksionit:

- i. kategorizimin e shkeljeve sipas natyrës,
- ii. shkallën e rëndësisë së shkeljeve, dhe
- iii. xhiron e ndërmarrjes.

i. Kategorizimi i shkeljeve

Ligji për mbrojtjen e të dhënave parashikon 2 (dy) kategori shkeljes:

1. Shkelje të denueshme me gjobë deri në 1 000 000 000 lekë ose 2% të xhiros vjetore, për vitin financiar paraardhës të kontrolluesit/përpunuesit, cilado është më e lartë.
2. Shkelje të dënueshme me gjobë deri në 2 000 000 000 lekë ose 4% të xhiros vjetore për vitin financiar paraardhës të kontrolluesit/përpunuesit, cilado është më e lartë.

ii. Shkalla e rëndësisë së shkeljes sipas rrethanave në çdo rast individual

Ligji parashikon se duhen të merren në konsideratë rrethanat që cilësojnë seriozitetin e shkeljes në një çështje individuale, të cilat përfshijnë elementet si më poshtë:

- **Natyra e shkeljes** vlerësohet në bazë të rrethanave konkrete të çështjes.

SECOND STEP: STARTING POINT FOR CALCULATING THE ADMINISTRATIVE SANCTION

The calculation of the sanction must start from a specific starting point.

The Commissioner's Office considers three (3) essential elements in determining the starting point for sanction calculation:

- i. Classification of violations by nature,
- ii. Degree of severity of the violations, and
- iii. Turnover of the enterprise.

i. Classification of Violations

The Personal Data Protection Law provides for two (2) categories of violations:

1. Violations sanctioned by a fine of up to 1,000,000,000 ALL or 2% of the annual turnover for the preceding financial year of the controller/processor, whichever is higher.
2. Violations sanctioned by a fine of up to 2,000,000,000 ALL or 4% of the annual turnover for the preceding financial year of the controller/processor, whichever is higher.

ii. Severity of the Violation in Individual Cases

The Law provides that circumstances determining the seriousness of the violation must be considered, including:

- **Nature of the violation** is assessed based on the concrete circumstances of the case.

Zyra e Komisionerit mund të marrë parasysh edhe interesin që synon të mbrojtë dispozita e shkelur dhe vendin e saj në kuadrin e mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe mund të marrë në konsideratë shkallën në të cilën shkelja përkatëse ka penguar zbatimin efektiv të dispozitës dhe përmbushjen e objektivit që ajo synon të mbrojtë.

- **Rëndësia e shkeljes** vlerësohet në bazë të rrethanave konkrete të çështjes, si më poshtë:

- **Natyra e përpunimit** përfshin kontekstin për të cilin kryhet ky përpunim si dhe të gjitha karakteristikat e përpunimit. Kur natyra e përpunimit sjell rreziqe më të larta, dhe kur subjekti i të dhënave dhe kontrolluesit janë në kushte të pabarabarta, Zyra e Komisionerit mund të konsiderojë t'i japë më shumë peshë këtij faktori.
- **Objekti i përpunimit** bazohet në objektin vendas ose ndërkufitar të përpunimit të kryer dhe marrëdhënies midis këtij informacioni dhe shtrirjes/gjerësisë reale të përpunimit, referuar burimeve të alokuara për këtë qëllim nga kontrolluesi.
- **Qëllimi i përpunimit** bazohet në shqyrtimin nëse qëllimi përbën veprimtarinë kryesore të përpunuesit. Sa më qendror të jetë përpunimi, aq më të rënda do të jenë parregullsitë në këtë përpunim.

The Commissioner's Office may also consider the interest that the violated provision aims to protect and its role within the personal data protection framework, as well as the extent to which the violation has hindered effective implementation of the provision and the achievement of the objective it seeks to protect.

- **The importance of the violation** is assessed based on the specific circumstances of the case, as follows:

- **Nature of processing** includes the context for which this processing is carried out as well as all the characteristics of the processing. Where the nature of the processing entails higher risks, and where the data subject and the controller are on an unequal footing, the Commissioner's Office may consider giving more weight to this factor.
- **The object of the processing** is based on the domestic or cross-border object of the processing carried out and the relationship between this information and the actual scope/breadth of the processing, with reference to the resources allocated for this purpose by the controller.
- **The purpose of processing** is based on the consideration of whether the purpose constitutes the core activity of the processor. The more central the processing is, the more serious the irregularities in this processing will be.

- **Numri i subjekteve të të dhënave** të cënuar konkretisht, dhe potencialisht.
- **Niveli i dëmit** të pësuar dhe dhe shkalla në të cilën sjellja mund të ndikojë në të drejtat dhe liritë individuale. Shkalla e dëmit të shkaktuar i referohet dëmit fizik, material ose jomaterial.

- **Kohëzgjatja e shkeljes** nënkupton që mund t'i jepet më shumë peshë një shkeljeje me kohëzgjatje më të madhe.

Karakteri i qëllimshëm (dashja) ose pakujdesia

Karakteri i qëllimshëm ose i pakujdesshëm i shkeljes duhet të vlerësohet duke marrë parasysh elementet objektive të sjelljes të mbledhura nga faktet e çështjes.

Kategoritë e të dhënave personale të prekura

Ligji thekson qartë llojet e të dhënave që meritojnë mbrojtje të veçantë dhe për rrjedhojë, një trajtim më të rreptë në kuadër të zbatimit të masave të sanksioneve. Sa më shumë kategori të tilla të dhënash të përfshihen, ose sa më sensitive të jenë të dhënat, aq më shumë rëndësi i jepet këtij faktori.

Klasifikimi i rëndësisë së shkeljes dhe identifikimi i shumës së pikënisjes së përlogaritjes së sanksionit administrative

Në shqyrtimin e rëndësisë së shkeljes, duhet t'i kushtohet vëmendje shkeljes në tërësi.

Zyra e Komisionerit mund të konstatojë se shkelja është e një shkalle rëndësie të ulët, mesatare ose të lartë.

- **The number of data subjects** actually and potentially affected.
- **The level of harm suffered** and the extent to which the conduct may affect individual rights and freedoms. The level of harm caused refers to physical, material or non-material damage.

- **The duration of the violation** means that more weight may be given to a violation of greater duration.

Intentional or Negligent Nature

The intentional or negligent nature of the violation must be assessed based on objective elements of conduct gathered from the facts of the case.

Categories of Personal Data Affected

The law clearly established the types of data that deserve special protection and, consequently, stricter treatment in the context of the implementation of sanctions measures. The more such categories of data are included, or the more sensitive the data, the more importance is given to this factor.

Classification of severity of the violation and identification of the starting amount of the calculation of the administrative sanction

In considering the significance of the violation, attention should be paid to the violation as a whole.

The Commissioner's Office may determine whether the violation is of a low, medium or high degree of importance.

- **Shkeljet me shkallë të ulët rëndësie:** pikënisja e përlllogaritjes së sanksionit përcaktohet në një interval që varion nga **0% deri në 10%** të tavanit ligjor të zbatueshëm.
- **Shkeljet me shkallë mesatare rëndësie:** pikënisja përcaktohet në një interval prej **10% deri në 20%** të tavanit ligjor të zbatueshëm, duke reflektuar një nivel më të lartë proporcionaliteti.
- **Shkeljet me shkallë të lartë rëndësie:** pikënisja e përlllogaritjes së mëtejshme vendoset në intervalin **20% deri në 100%** të tavanit ligjor të zbatueshëm, duke synuar një masë ndëshkimore më të ashpër dhe me karakter parandalues.

RREGULL I PËRGJITHSHËM: sa më e rëndë të jetë shkelja brenda kategorisë së saj, aq më e lartë ka të ngjarë të jetë pikënisja e përlllogaritjes.

Xhiroja e ndërmarrjes si element për vendosjen e një sanksioni efektiv, proporcional dhe me karakter parandalues.

Masa e gjobës duhet të jetë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues në çdo rast individual. Zyra e Komisionerit duhet të përshtasë masat e sanksioneve, pa kaluar tavanin ligjor përkatës.

a. Për ndërmarrjet e vogla:

- **Xhiro ≤ 10 milion lekë:** sanksioni përlllogaritet mbi bazën e një shume deri në 0.2% të pikënisjes së identifikuar.
- **Xhiro ≤ 50 milion lekë:** sanksioni përlllogaritet mbi bazën e një shume deri në 0.3% të pikënisjes së identifikuar.

- **Violations of low importance:** the starting point for calculating the sanction is set in a range ranging from **0% to 10%** of the applicable legal ceiling.
- **Violation of medium importance:** the starting point is set in a range of **10% to 20%** of the applicable legal ceiling, reflecting a higher level of proportionality.
- **Violations of high importance:** the starting point for further calculation is set in the range of **20% to 100%** of the applicable legal ceiling, aiming at a more severe and deterrent punitive measure.

GENERAL RULE: the more severe the violation within its category, the higher the starting point of the calculation is likely to be.

Enterprise Turnover as an Element for Setting an Effective, Proportional, and Deterrent Sanction

The fine must be effective, proportional, and deterrent in each individual case. The Commissioner's Office must adjust sanctions without exceeding the legal ceiling.

a. For small enterprises:

- **Turnover ≤ 10 million ALL:** the sanction is calculated based on an amount of up to 0.2% of the identified starting point.
- **Turnover ≤ 50 million ALL:** the sanction is calculated based on an amount of up to 0.3% of the identified starting point.

- **Xhiro ≤ 250 milion lekë:** sanksioni përlogaritët mbi bazën e një shume deri në 5% të pikënisjes së identifikuar.

b. Për ndërmarrjet e mesme e të mëdha:

- **Xhiro ≤ 500 milion lekë:** sanksioni përlogaritët mbi bazën e një shume deri në 8% të pikënisjes së identifikuar.
- **Xhiro ≤ 1 miliard lekë:** sanksioni përlogaritët mbi bazën e një shume deri në 15% të pikënisjes së identifikuar.
- **Xhiro > 1 miliard lekë:** sanksioni përlogaritët mbi bazën e një shume deri në 40% të pikënisjes së identifikuar.

RREGULL I PËRGJITHSHËM:

sa më i madh të jetë qarkullimi i ndërmarrjes brenda nivelit të zbatueshëm për të, aq më e madhe ka të ngjarë të jetë pikënisja e përlogaritjes.

Zyra e Komisionerit nuk është e detyruar të zbatojë këtë rregullim për të përshtatur pikënisjen e përlogaritjes, nëse kjo nuk paraqitet e nevojshme nga pikëpamja e efektivitetit, proporcionalitetit dhe karakterit parandalues i sanksionit.

HAPI 3: RRETHANAT RËNDUESE DHE LEHTËSUESE

Zyra e Komisionerit duhet të marrë parasysh edhe çdo rrethanë tjetër rënduese ose lehtësuese, që lidhet me rrethanat e çështjes, si përfitimet financiare ose humbjet e shmangura, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga shkelja.

- **Turnover ≤ 250 million ALL:** the sanction is calculated based on an amount of up to 5% of the identified starting point.

b. For medium and large enterprises:

- **Turnover ≤ 500 million ALL:** the sanction is calculated based on an amount of up to 8% of the identified starting point.
- **Turnover ≤ 1 billion ALL:** the sanction is calculated based on an amount of up to 15% of the identified starting point.
- **Turnover > 1 billion ALL:** the sanction is calculated based on an amount of up to 40% of the identified starting point.

GENERAL RULE: The higher the enterprise turnover within its applicable level, the higher the starting point is likely to be.

The Commissioner's Office is not obliged to apply this regulation to adjust the starting point for the calculation, unless this appears necessary from the point of view of the effectiveness, proportionality and deterrent nature of the sanction.

THIRD STEP: AGGRAVATING AND MITIGATING CIRCUMSTANCES

The Commissioner's Office must also take into account any other aggravating or mitigating circumstances related to the circumstances of the case, such as financial benefits or losses avoided, directly or indirectly from the violation.

Niveli i sanksionit do të varet nga të gjitha elementet e grumbulluara gjatë hetimit administrativ dhe nga konsiderata të mëtejshme të lidhura edhe me përvojat e mëparshme të aplikimit të sanksioneve administrative.

Veprimet e kontrolluesit/përpunuesit në zbutjen e dëmit të pësuar nga subjektet e të dhënave

Marrja e masave të përshtatshme për zbutjen e dëmit të pësuar nga subjektet e të dhënave mund të konsiderohet si një faktor lehtësues, duke zvogëluar, kështu, masën e sanksionit.

Shkalla e përgjegjësisë së kontrolluesit/përpunuesit

Shkalla e përgjegjësisë së kontrolluesit ose përpunuesit do të duhet të vlerësohet duke marrë parasysh masat e zbatuara prej tyre, në përputhje me përgjegjësitë e parashikuara me ligj dhe masat e marra për të garantuar sigurinë e përpunimit.

Shkeljet e mëparshme të kontrolluesit/përpunuesit

Çdo shkelje e mëparshme e kryer nga kontrolluesi ose përpunuesi duhet të merret parasysh kur vendoset nëse do të vendoset një sanksion dhe kur përcaktohet masa e saj.

a. Korniza kohore

Sa më e gjatë të jetë koha midis një shkeljeje të mëparshme dhe shkeljes që është në hetim administrativ, aq më e ulët është rëndësia e saj.

b. Çështja

Shkeljet e mëparshme të të dhënave të një subjekti, të njëjtë ose të ndryshëm me atë që po hetohet, mund të konsiderohen si "të rëndësishme".

The level of the sanction will depend on all the elements collected during the administrative investigation and on further considerations related to previous experiences of applying administrative sanctions.

Actions of the controller/processor in mitigating the harm suffered by data subjects

Taking appropriate measures to mitigate the harm suffered by data subjects may be considered a mitigating factor, thus reducing the amount of the sanction.

Degree of responsibility of the controller/processor

The degree of responsibility of the controller or processor will have to be assessed taking into account the measures implemented by them, in accordance with the responsibilities provided for by law and the measures taken to ensure the security of the processing.

Previous infringements of the controller/processor

Any previous infringements committed by the controller or processor must be taken into account when deciding whether to impose a sanction and when determining its amount.

a. Time frame

The longer the time between a previous breach and the breach under administrative investigation, the lower its significance.

b. Issue

Previous data breaches of an entity, the same or different from the one under investigation, may be considered "significant".

c. Vlerësime të tjera

Ekzistenca e shkeljeve të mëparshme mund të konsiderohet si një faktor rëndues në përlogaritjen e masës së sanksionit. Ky faktor duhet të përcaktohet duke pasur parasysh natyrën dhe shpeshtësinë e shkeljeve të mëparshme.

Shkalla e bashkëpunimit me Zyrën e Komisionerit

Zyra e Komisionerit merr parasysh shkallën e bashkëpunimit të kontrolluesit ose përpunuesit, në mënyrë që të korrigjohet shkelja përkatës dhe të zbuten efektet e mundshme negative të saj.

Njoftimi i Zyrës së Komisionerit

Mënyra në të cilën Zyra e Komisionerit është vënë në dijeni për shkeljen mund të përbëjë një faktor rëndues ose lehtësues për përlogaritjen e masës së sanksionit.

Përputhshmëria me detyrat e lëna më herët për të njëjtën çështje

Zbatimi i masave korrigjuese, kur përpara shkeljes këto masa janë dhënë ndaj kontrolluesit ose përpunuesit në lidhje me të njëjtën çështje duhet të merret parasysh në vlerësimin nëse ndaj kontrolluesit/përpunuesit do të vendoset sanksioni administrativ gjorbë, si dhe në përcaktimin e masës së saj.

Respektimi i kodeve të miratuara të sjelljes dhe/ose mekanizmave të miratuar të certifikimit

